

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sikalastic® Metal Primer

PRAJMER EPOKSID ME 2 PËRBËRËS PËR NËNSHTRESA METALIKE TË EKSPOZUARA DHE BITUMINOZE.

### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikalastic® Metal Primer është prajmer me 2 përbërës, kundër korrodimit të nënshtresave metalike të ekspozuara dhe prajmer bllokues për veshjet dhe membranat bituminoze.

### PËRDORIMET

Prajmer për shumë aplikime dhe kundër korrodimit të nënshtresave metalike për përdorim me:

- SikaRoof® MTC
  - sisteme për çati/tarraca Sikalastic®
  - sisteme për hidroizolim tarracash Sikafloor®
  - veshje higjienike Sikagard®
- Barrierë kundër migrimit të bitumit fluror apo plastifikatorëve

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Tharje e shpejtë, mbiveshja e mundur pas 6 orësh
- Mbrojtje kundër korrodimit në mjedise industriale dhe detare
- Aplikim i lehtë me furçë ose rul
- Përmirëson ndërkapjen mbi një gamë të gjerë nënshtresash metalike
- Mbron kundër migrimit të bitumit fluror apo plastifikatorëve

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

<b>Baza kimike</b>	rrëshirë epokside me bazë tretësi dhe forcues poliamidi
<b>Ambalazhi</b>	kovë 5.0 l (~7.17 kg) Përbërësi A: 2.5 l (~3.7 kg) Përbërësi B: 2.5 l (~3.47 kg)
<b>Paraqitja / Ngjyra</b>	Përbërësi A: lëng rrëshirë ngjyrë perle gri Përbërësi B: lëng kafe rrëshirë
<b>Jetëgjatësia</b>	12 muaj nga data e prodhimit
<b>Kushtet e magazinimit</b>	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +35°C. Temperaturat më të larta të magazinimit mund të reduktojnë jetëgjatësinë e produktit. Referohuni tek rekomandimet për magazinimin që jepen në fletën me të dhënat e sigurisë.
<b>Dendësia</b>	~1.43 kg/l (23 °C) <span style="float: right;">(EN ISO 2811-1)</span>

# INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	Përbërësi A : Përbërësi B = 1:1 (për vëllim)
Konsumimi	Aplikoni në një veshje, me konsumim ~ 0.15 l/m <sup>2</sup> (~ 0.20 kg/m <sup>2</sup> ) për veshje në varësi të ashpërsisë së sipërfaqes dhe absorbueshmërisë.
Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +40 °C max.
Lagështia relative e ajrit	max. 80 % lagështi relative
Pika e vesës	Kujdes kondensimin. Nënshtrësja dhe veshja e patharë duhet të jenë ≥3 °C mbi pikën e vesës.
Temperatura e nënshtrësës	+5 °C min. / +40 °C max.
Lagështia e përmbajtur e nënshtrësës	Pa lagështi dhe kondensim në dukje
Koha e pritjes / mbiveshja	Aplikoni Sikalastic® Metal Primer brenda 4 orëve pas bluarjes, përpara ri-oksimit.

Përpara aplikimit të çdo produkti të rekomanduar SikaRoof® MTC, Sikalastic®, Sikafloor® ose Sikagard® mbi Sikalastic® Metal Primer, lejoni:

Temperatura e nënshtrësës	Koha min. e pritjes	Koha max. e pritjes	I thatë në prekje pas:
+10 °C	~ 12 orë	7 ditë	~ 6 orësh
+20 °C	~ 6 orë	7 ditë	~ 3 orësh
+30 °C	~ 5 orë	7 ditë	~ 2 orësh

Shënim: Aplikoni veshje shtesë nëse kalojnë më tepër se 7 ditë përpara veshjes.

Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të ambientit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS

Sipërfaqet duhet të jenë e pastra, të thata, pa kontaminues dhe pa vaj, graso, silane, kripëra, silikon, siloksane dhe kimikate të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndërkapje të dobët.

### PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Të gjitha sipërfaqet që do të vishen duhet të pastrohen plotësisht me mjete konvencionale.

Çeliku duhet përgatitur me fryrje saçmash deri në Sa 21/2 ose SSPC 10 (metal pothuajse i bardhë). Kur nuk lejohet fryrja, atëherë pranohet pastrimi dhe përgatitja e metalit me vegla elektrike.

Metalet joferroze përgatiten duke hequr depozitat e pluhurit dhe oksidimit dhe me smerilizim deri sa të shfaqet metali i bardhë. Fërkimi me tel mund të përdoret mbi metalet e buta, p.sh. bakri.

Sigurohuni se sipërfaqet nuk kanë lagështi të dukshme dhe se i gjithë pluhuri, materiali i shkrifët dhe i lirë është hequr plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit, preferohet me furçë dhe/ose fshesë thithëse.

Në rast dyshimi aplikoni më parë në një zonë për provë.

Për informacione të detajuara rreth cilësisë/përgatitjes së nënshtrësës dhe tabelës së prajmerit ju lutemi referohuni tek Method Statement.

## APLIKIMI

Përgatisni Sikalastic® Metal Primer duke përzierë përbërësin A derisa të homogjenizohet, shtoni përbërësin B dhe përzieni me mikser elektrik derisa të arrihet ngjyra e njëtrajtshme. Sikalastic® Metal Primer mund të aplikohet me rrul me qime të shkurtëra ose furçë. Lejoni që prajmeri të thahet mjaftueshëm (shih tabelën e kohës së pritjes / mbiveshjen) përpara mbiveshjes.

## MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Thinner C menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar dhe/ose i tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

## KUFIZIME

- Të mos aplikohet në mot të lagësht apo mbi sipërfaqe të lagura.
- Të mos përdoret Sikalastic® Metal Primer për aplikime në mjedise të brendshme.
- Siguroni gjithmonë ventilim të mirë kur përdorni Sikalastic® Metal Primer në zonë të mbyllur, për të siguruar tharjen dhe maturimin e plotë.
- Çdo sipërfaqe e pambuluar për një periudhë më tepër se 7 ditë duhet të lyhen sërish me prajmer.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

### UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (Kategori Produkti IIA / j lloji sb) është 500 g/l (Kufijtë 2010) për produkt gati për përdorim. Përmbajtja maksimale e Sikalastic® Metal Primer është < 500 g/l VOC për produkt gati për përdorim.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
Sikalastic® Metal Primer  
Shkurt 2019, Botimi 01.01  
020915951000000006

SikalasticMetalPrimer-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf

